34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të**

pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t’i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t’i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t’i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t’i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Përkufizimet	1.3	Sipas kushteve të përgjithshme.
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës, që është në shumë prej: 32,543.04 €, me garancion: a) Bankar nga një bankë e licencuar në Kosovë, ose b) Kompani e sigurimesh e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: [24 muaj + 30 ditë], nga data e nënshkrimit të kontratës. - Pas përfundimit të punimeve dhe pranimi të tyre nga Organi mbikqyrës dhe Menaxheri i Kontratës, Kontraktuesi duhet të depozitojë Sigurimin e përmbushjes në vlerë: 10 % nga vlera e punimeve të realizuara si garancë për kualitetin dhe cilësinë e punëve në afatin prej: 12 muaj nga data e pranimi të punimeve të Situacionit përfundimtar nga Organi mbikqyrës dhe Menaxheri i Kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definiuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, sëbashku me materialin dhe impiantin gjer në kosoton e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Ndëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësive të lejuara nga organi mbykqyrës. Kontrata është: 24 muaj.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve të përgjithshme të kontratës. Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Z.K.A.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacionin.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% të vlerës së kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë.
Përgjegjësi mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është: 365 ditë.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA PËR OBJEKTIN : SHKOLLA FILLORE E MESME E ULËT - RETI

SHFMU "Haki Stërmilli"

P+0

Reti, K.K. Rahovec

A. PUNËT ARKITEKTONIKE


A.1	PUNËT PËRGATITORE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.1.1	Rrethimi i truallit për ndërtimin e objektit, lartësia e rrethojës duhet të jetë ~2.0m	komplet	1.00	150.00 €	150.00
A.1.2	Pastrimi i terrenit - hapësirës nga papastërtitë, mbeturinat dhe pengesat e ndryshme, të cilat pengojnë zhvillimin e punëve, si dhe largimi i tyre në deponi të caktuara nga investitori, mbikqyesi, apo punëkryesi.	komplet	1.00	50.00 €	50.00
A.1.3	Inqizimi gjeodezik i parces, si dhe caktimi i pikave të objektit dhe fushës së sportit në terren duke ju përshtatur parces ekzistuese dhe projektit	komplet	1.00	50.00 €	50.00
A.1.4	Përgatitja e punishtës, transporti i mjeteve, stabilimenteve dhe paisjeve tjera të nevojshme për punë	komplet	1.00	50.00 €	50.00
A.1.5	Furnizimi, montimi dhe rregullimi i zyrevë të përkohshme në vendin e ndërtimit, zyret duhet të plotësojnë kushtet standarte për punë, të paisura me inventar, kompjuter, rrym, internet etj.	komplet	1.00	50.00 €	50.00
A.1.6	Punimi i tabelës me dimensione 140x80, e cila shënon emrin e projektit, Investitorin, punëkryesin etj.	copë	1.00	30.00 €	30.00
A.1.7	Furnizimi me material, si dhe vendosja e sinjalizimit adekuat, tabelat informuese të punishtës, shenjat e nevojshme të sigurisë në punë etj.	komplet	1.00	20.00 €	20.00
A.1.8	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kantjerit.	komplet	1.00	50.00 €	50.00
A.1.9	Ekzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër të tyre si: tamponit, betonit, armatës elementeve tjera për shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë mostrat, ateste paraprake dhe përdorimin e materialit para fillimit të punimeve. Pastaj pas vuarjes në vepër, nga menaxheret e projektit do të meren mostrat në terren për keto materiale sipas standardeve dhe rregulloreve në fuqi, dhe do të ekzaminohen në laborator, shpenzimet për të gjitha keto pozicione duhet të bartë punëkryesi.	komplet	1.00	300.00 €	300.00
GJITHSEJ:					750.00

A.2	PUNËT E DHEUT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.2.1	Gërmimi i gjerë i dheut të kategorisë IV dhe V për rrafshimin e terrenit, hapjen e rrugës për automjete, rruges për kembësore. etj. Materiali i gërmuar largohet në deponi legale, dhe rivendosja e dheut në hapësirat e nevojshme për mbushje. Gërmimi duhet të kryhet konformë rregullave teknike të ndërtimit.	m ³	4,840.00	0.50 €	2,420.00
A.2.2	Gërmimi i dheut me makine dhe me dorë të kategorisë IV dhe V-të, për hapjen e themeleve të veqara, pllakore dhe shiritore. Materiali i gërmuar në raste nevojë do të përdoret për mbushjen dhe nivelizimin e oborrit. Gërmimi duhet të kryhet konformë rregullave teknike të ndërtimit. Në qmim të kalkulohet gërmimi si dhe planifikimi i materialit. Në çmim të llogaritet dhe ngjeshja e dheut deri në masë të nevojshme.	m ³	450.00	0.50 €	225.00
GJITHSEJ:					2,645.00

A.3	PUNËT E ZHAVORRIT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.3.1	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja deri në masën e duhur e zhavorit 0-60 mm nën themelet të veqara, pllakore dhe nën cokëll me trashësi d=30 cm mbi dheun e ngjeshur me mekanizëm përkates	m ³	150.00	5.00 €	750.00
A.3.2	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit mbushës adekuat nga guri i thyer për arritjen e kuotes ±0 të pllakes së dyshemes, materiali duhet të ngjeshet mirë dhe atë në shtresë t=20.0 cm	m ³	420.00	3.00 €	1,260.00
A.3.3	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja mirë e zhavorit 0-60 mm deri në masën e duhur nën pllaken e dyshemes (mbi materialin e vendosur me parë (poz. A.3.2) me trashësi t=20 cm,	m ³	250.00	4.00 €	1,000.00
A.3.4	Furnizimi, hudhja, mbushja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31 mm, me trashësi t=15 cm në hapsirat për rreth cokllave për realizimin e drenazhes	m ³	95.00	5.00 €	475.00
GJITHSEJ:					3,485.00




A.4	PUNËT BETONUESE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.4.1	Furnizimi me material dhe betonimi i nën shtresave të betonit të „Varfër“ nën themelet e veqara nënshtrës t=5.0 cm si shtresë mbrojtëse e armatures, betoni C-20 Mpa,	m ³	28.00	30.00 €	840.00
A.4.2	Furnizimi me material patinimi dhe betonimi i themeleve të veqanta , pllakore si dhe coklla me beton C-25/30 Mpa , me pahi adekuate komplet sipas projektit,	m ³	310.00	50.00 €	15,500.00
A.4.3	Furnizimi, latimi dhe betonimi i pllakes së dyshemes t=20.0 cm me beton të armuar C- 25/30 MPA ne teresi sipas projektit.	m ³	150.00	50.00 €	7,500.00
A.4.4	Furnizimi, latimi dhe betonimi i shtyllave me beton të armuar C-25/30 MPA në kallupet përkatëse sipas projektit.	m ³	20.00	50.00 €	1,000.00
A.4.5	Furnizimi, latimi dhe betonimi i trajeve kryesor dhe sekondare nëpër tërë lartësitë e objektit me beton të armuar C-25/30 MPA në kallupet përkatëse sipas projektit.	m ³	35.00	50.00 €	1,750.00
A.4.6	Furnizimi, latimi dhe punimi i pllakes së meskatit të tipit fert me ne llogari të merret fert trajet të dimensionuara sipas hapsirave perkatëse dhe montat ne teresi sipas projektit	m ²	650.00	12.00 €	7,800.00
A.4.7	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakes mbi fertit me beton C-25/30 Mpa ne teresi sipas projektit	m ²	650.00	4.50 €	2,925.00
A.4.8	Furnizimi, latimi dhe betonimi i simsit, dhe pllakes së parahyrjes me beton të armuar C-25/30 MPA në kallupet përkatëse sipas projektit.	m ³	15.00	55.00 €	825.00
A.4.9	Latimi dhe betonimi i shkallëve të parahyrjes dhe pjerinave (rampave) me beton C-25/30 Mpa në kallupet përkatëse sipas projektit.	m ³	5.50	55.00 €	302.50
A.4.10	Latimi dhe betonimi i arkitrajeve, trajeve shtangues si dhe elementeve tjera me beton C-25/30 Mpa në kallupet përkatëse sipas projektit.	m ³	20.00	50.00 €	1,000.00
A.4.11	Furnizim me material dhe punimi i shtresës së estrihut në përdheshë e plotësuar me fibra dhe e trajtuar me makinë me trashësi 4-5cm në pozicion të parashihet edhe punim i shtresave izoluese stirodurit N4 t= 2 cm dhe shtresës hidroizoluese.	m ²	650.00	5.50 €	3,575.00
A.4.12	Furnizimi me material dhe punimi i shtresës mbrojtëse të termoizolimit mbi pllaken e kulmit nga betoni C-20 Mpa me trashësi t~4.0 cm e plotësuar me rrjete Q84 (Ø4/15/15 cm) në pozicion të parashihet edhe punim i shtresave termoizoluese stirodurit t= 5 cm dhe PVC Folje.	m ²	710.00	7.00 €	4,970.00
A.4.13	Betonimi i trotuareve për rreth objektit me beton të ngjeshur C-25/30 Mpa, trashësi t=10 cm. Në çdo 2m' të trotuarit të punohet fuga. Trotuari ka gjerësi b=80cm. Në qmim të kalkulohet përgatitjet paraprake të dheut, si dhe shtresat e zhavorrit me ngjeshje t=15 cm	m ²	160.00	11.00 €	1,760.00
GJITHSEJ:					49,747.50
A.5	PUNËT E ARMATURËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.5.1	Furnizimi, transporti ,prerja si dhe vendosja e armaturës ÇBR-400/500 Mpa në tërësi sipas llogarisë statike. - RA 400/500 - Ø8; - RA 400/500 - Ø 10 - RA 400/500 - Ø 12 - RA 400/500 - Ø14 - RA 400/500 - Ø 16 Llogaria në kg	kg	38,850.00	0.53 €	20,590.50
A.5.2	Furnizimi, transporti, prerja dhe vendosja e rrjetave në dysheme dhe meskat Q-378 me specifikacion Ø8.5x15x15 cm	kg	13,250.00	0.53 €	7,022.50
GJITHSEJ:					27,613.00



A.6	PUNËT E MURATIMIT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.6.1	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve te jashtme me giter blloka d = 25cm me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit	m ³	72.00	35.00 €	2,520.00
A.6.2	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve te mbrendshme me giter bllok d = 25cm me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit.	m ³	90.00	35.00 €	3,150.00
A.6.3	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve te mbrendshme me giter bllok d = 20cm me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit.	m ³	21.00	35.00 €	735.00
A.6.4	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve ndarese me giter bllok ose tulle d=12 cm me llaq vazhdues 1:2:6	m ²	45.00	22.00 €	990.00
A.6.5	Furnizimi me material dhe muratimi i atikes me giter bllok d=20 cm me llaq vazhdues 1:2:6, ne kete qmim llogaritet edhe shtangimi me shtylla dhe trazezen e betonit	m ³	35.00	35.00 €	1,225.00
A.6.6	Furnizimi me material dhe muratimi i oxhakut të kalldatores. Të punohet prej elementeve të parafabrikuara me diametër të brendshëm Ø 250 mm, nga blloqet e shamotit me elementet e kyqjes së kalldatores, kapela etj.	m'	6.00	55.00 €	330.00
A.6.7	Furnizimi me material dhe veshja e oxhakut mbi pllakën e meskatit me tulla fasadë, me dimensione standarde 25x12x6.5 cm. Në çmim të parashihet edhe vendosja e kokës së oxhakut.	m'	2.00	40.00 €	80.00
				GJITHSEJ:	9,030.00

A.7	PUNËT LATUESE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.7.1	Furnizimi me material dhe punimi i konstruksionit të kulmit komplet mbi pllakë nga druri i përpunuar, në tërësi sipas projektit. Llogaria në m ² ne projeksinin horizontal te kulmit	m ²	680.00	11.00 €	7,480.00
A.7.2	Furnizimi dhe vendosja e dërrasave t=24 mm mbi, konstruksionin përkatës, si bazament për vendosjen e letres difuzive dhe listelave. Llogaria në m ² ne projeksinin horizontal te kulmit	m ²	680.00	2.00 €	1,360.00
A.7.3	Furnizimi dhe vendosja e kontra listellave 3/5 në çdo 70cm, apo paralel me pahit. Llogaria në m ² ne projeksinin horizontal te kulmit	m ²	680.00	0.70 €	476.00
A.7.4	Furnizimi dhe vendosja e listelave 5/8 në çdo 60cm te cilat montohen mbi kontralistela. Llogaria në m ² ne projeksinin horizontal te kulmit	m ²	680.00	1.70 €	1,156.00
				GJITHSEJ:	10,472.00


A.8	PUNËT MBULUESE DHE TË LLAMARINËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.8.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbulesës së kulmit me llamarinë të plastifikuar dhe valëzuar LV-4 me shtrësen kunder kondensioni Në ngjyrë sipas zgjedhjes së investitorit. Llamarina duhet te jete me lugje ne lartesi hmin. 4.0 cm Llogaria në m ² ne projeksinin horizontal te kulmit, Ne kete pozicion te llogariten, mbrojtësit e bores si dhe elementet tjera lidhese	m ²	720.00	5.30 €	3,816.00
A.8.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i mveshjes se murit të atikes nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm. Me gjerësi zhvilluese b=1.60 m.	m ²	270.00	4.50 €	1,215.00
A.8.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve horizontal nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm, duke parapa edhe shtrësen hidroizoluese nen ulluk	m'	52.00	4.50 €	234.00
A.8.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve vertical nga llamarina e plastifikuar me dimensione Ø12cm, t=0.55mm	m'	21.00	4.50 €	94.50
A.8.5	Furnizimi dhe montimi i llamarinës së plastifikuar ne nuance te kulmit per punimin e mveshjeve te oxhakut. Llogaria per copë	copë	1.00	120.00 €	120.00
				GJITHSEJ:	5,479.50



[Handwritten signature]


A.9	PUNËT HIDROIZOLUESE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.9.1	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal me saldim të lidhjeve në nivelin e pllakes se dyshemes, hidroizolimi punohet me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, t=3mm dhe me nje shtrese lyerje bituliti. Llogaria ne m² dhe të punohet para muratimit	m²	650.00	3.80 €	2,470.00
A.9.2	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal në dysheme dhe vertikal në lartësi h=90cm me saldim të lidhjeve në muret e kthinave sanitare në perdhesë me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, me DY SHTRESA t=2x3mm dhe në mes të shtresave lyerje me bitulit.	m²	60.00	3.80 €	228.00
A.9.3	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit te ftohte ne dy shtresa ne dyshemen e nyjeve sanitare mbi nivelizim	m²	35.00	4.50 €	157.50
A.9.4	Furnizimi dhe shtrirja e letres difuzive mbi sipërfaqen paraprakisht të mveshur me dërrasa të konstruksionit te kulmit, perfshire te gjitha punet pergatitore. Llogaria në m² ne projektionin horizontal te kulmit	m²	720.00	1.30 €	936.00
GJITHSEJ:					3,791.50

A.10	PUNËT E ZDRUKTHËTARISË	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
	Funizimi, punimi dhe montimi i dritareve prej materialit të plastikës sipas standardeve ISO, DIN				
	• Korniza ngjyrë e bardhë				
	• Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë, U<0.9 W/m²K				
	• Xham I trefishtë 4+4+16+4 mm, i mbushur me argon dhe Low "E" katër sezonal.				
	• Korniza e profilat min 6 fusha termike dhe së paku b/h=80/80 mm trashësi dhe tre goma/dihtunga				
	• Profili i brendshëm strukturore metalike min=2 mm instaluar brenda kornizës së PVC-së				
	• Profili shtesë/kornizë për mbështetjen e pikores dhe solobankës				
	• Mekanizmi mbyllës me kualitet të lartë sipas DIN, EN, ISO				
	• Izolim akustik 40 dB				
	• Membrana e jashtme me veti të lëshueshmërisë së avujve, fleksibile, e padepërtueshme nga ajri, era dhe shiu në tërë perimetrin e jashtëm të dritares				
	• Membrana e brendshme me veti të palëshueshmërisë së avujve, fleksibile, e padepërtueshme nga ajri, era dhe shiu në tërë perimetrin e brendshëm të dritares				
	• Instalimi të bëhet me ankerim dhe bulona.				
	• Sigurimi i certifikatës së konformitetit (certificates of conformity) për çdo produkt				
	• Dimensionet e dritares				
A.10.1	dimensione 430x210 cm	copë	10.00	570.00 €	5,700.00
A.10.2	dimensione 210x210 cm	copë	9.00	330.00 €	2,970.00
A.10.3	dimensione 80x60 cm	copë	6.00	280.00 €	1,680.00
A.10.4	dimensione 430x60 cm	copë	5.00	260.00 €	1,300.00
	Furnizimi dhe montimi i dritareve hyrëse prej profileve të plastikës sipas standardeve ISO, DIN. Te perforcuar prej profileve te metalit Trashesie t=8 cm ne hapje sipas projektit(detaleve te dritareve) me qelq termopan dhe mekanizma te kualitetit te larte				
A.10.5	dimensione 280x300 cm (dera hyrese)	copë	1.00	380.00 €	380.00
	Furnizimi dhe montimi i deres se erembrojtësit (fluturuese) prej profileve te plastikës me trashësi te profileve 8 cm sipas standardeve ISO, DIN. Te perforcuar prej profileve te metalit ne niance sipas perzgjedhjes se investitorit dhe qelqim sipas skemës				
A.10.6	dimesione 180*240	copë	1.00	270.00 €	270.00
	Furnizimi dhe montimi i deres se jashtme se çerdhes prej profileve te plastikës me trasheësi te profileve 8 cm sipas standardeve ISO, DIN. Te perforcuar prej profileve te metalit ne niance sipas perzgjedhjes se investitorit dhe qelqim sipas skemës				
A.10.7	dimesione 100x240	copë	1.00	180.00 €	180.00
	Furnizimi dhe montimi i dyerve te Nyjeve Sanitare nga materijali i plastikës sipas ISO,DIN standardeve trashesija e profilat t=8cm				
A.10.8	dimensione 80x210 cm	copë	4.00	110.00 €	440.00
A.10.9	dimensione 100x210 cm	copë	2.00	120.00 €	240.00
A.10.10	dimensione 70x210 cm	copë	7.00	100.00 €	700.00
	Furnizimi dhe montimi i dritareve të klaseve dhe kthinave tjera nga druri-furniri. Dyert duhet te jene te klasit te pare, dhe me te gjitha elementet tjera percjellese				
A.10.11	dimesione 100X240 cm	copë	6.00	130.00 €	780.00
A.10.12	dimesione 90X210 cm	copë	5.00	120.00 €	360.00
A.10.13	dimesione 90X240 cm	copë	2.00	130.00 €	260.00




[Handwritten signature]

	Furnizimi, prodhimi dhe instalimi i derës të hyrjes ekonomike të kthina e kaldasë të jetë metalike e ngjyrosur me ngjyrë adekuate kundër korezionit si dhe duhet të ketë grila për ajrosje. Të punohet sipas teknologjisë së prodhimit të dyerve të rënda ku përfshihen: Bagllamat, dorezat, manshetat, mekanizmi mbyllës komplet (cilindri, pllakat, çelësat), bravat, etj. Çmimi për copë.				
A.10.14	dimesione 140x240 cm (dy kriheshe)	copë	1.00	350.00 €	350.00
GJITHSEJ:					15,610.00
A.11	PUNËT SUVATUESE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.11.1	Furnizimi me material, pastrimi dhe sperkatja me qumshte qimentoje e mureve të brendshme dhe pllafoneve para fillimit të suvatimit. Llogaria në m ²	m ²	2,100.00	0.60 €	1,260.00
A.11.2	Furnizimi me material, dhe punimi i suvatimit të mureve të brendshme me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy shtresa me finalizim të lëmuar. Në pozicion të parashihet vendosja e kendoreve në të gjitha kendet	m ²	1,450.00	2.50 €	3,625.00
A.11.3	Suvatimi i pllafoneve me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy duar me finalizim të lëmuar. Në pozicion të parashihet vendosja e kendoreve në të gjitha kendet.	m ²	650.00	2.30 €	1,495.00
GJITHSEJ:					6,380.00
A.12	PUNËT E GLETIT DHE NGJYROSJES	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.12.1	Furnizimi me material dhe gletimi i të gjitha mureve të brendshme në dy shtresa (ketu nuk parashihen muret të nyjet sanitare), paraparakishte të bëhet përgaditja me lenden baze, sipërfaqja duhet të jetë e lëmuar dhe gatshme për ngjyrosje.	m ²	1,650.00	2.30 €	3,795.00
A.12.2	Furnizimi me material dhe gletimi i pllafoneve në dy shtresa paraparakishte të bëhet përgaditja me lenden baze, sipërfaqja duhet të jetë e lëmuar dhe gatshme për ngjyrosje, në pozicionin e plafonit janë marrë në sipërfaqe katror trajet e leshuara	m ²	650.00	2.30 €	1,495.00
A.12.3	Ngjyrosja e mureve të mbrendshme dhe pllafoneve mbi bazament të gletuar me polikolor në dy shtresa me niansë të bardhë.	m ²	2,810.00	0.70 €	1,967.00
A.12.4	Furnizimi dhe lyerja e mureve të klasave dhe koridoreve me ngjyrë të yndyrshme në lartësi h = 1.5 m.	m ²	450.00	0.70 €	315.00
A.12.5	Furnizimi me material dhe ngjyrosja me ngjyrë akrilike e shtyllave rrethore të jashtme dekorative, paraparakishte sipërfaqet të trajtohen dhe lyhen me baze	m ²	30.00	3.00 €	90.00
GJITHSEJ:					7,662.00
A.13	PUNËT E FASADËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.13.1	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës së jashtme nga tullat e fasadës dizajni dhe forma sipas organit mbikqyrës, në qmim të kalkulohet inkastrimet e nevojshme, trau i poshtëm dhe shtangimet tjera nga beton armeja, punimi i shtresës termoizoluese nga leshi i gurit me dy shtresa 5.0 cm të mbeshtjellur me foli të integruar difuzive, llogaria në m ²	m ²	450.00	20.00 €	9,000.00
A.13.2	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës së jashtme-atika nga tullat e fasadës dizajni dhe forma sipas organit mbikqyrës, në qmim të kalkulohet inkastrimet e nevojshme, shtangimet nga beton armeja, llogaria në m ²	m ²	150.00	20.00 €	3,000.00
A.13.3	Furnizimi transporti dhe punimi i "DEMIT" Fasadës nën dhe në pjesën anësore (ballore) të pllakës së simsit me këto shtresa: Ngjitës Stiropor N4 T= 3 cm Ngjitës Rrjetë plastike adekuate Ngjitës Fasadex 3 mm	m ²	110.00	7.00 €	770.00
A.13.4	Furnizimi dhe ekzekutimi i kolirit në cokull dhe pjesën e mureve të ngritura të cokolles në niansë sipas përzgjedhjes së organit mbikqyrës paraparakishte sipërfaqja duhet të përgaditet dhe lyhet me shtresat e nevojshme	m ²	60.00	3.00 €	180.00
GJITHSEJ:					12,950.00




A.14	PUNËT E QERAMIKËS, GRANITIT DHE MERMERIT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.14.1	Furnizimi me material dhe mvëshja e mureve (sanitaret) me pllaka të qeramikës te kualitetit te lartë, me ngjites adekuat, ne qmim te parashihen edhe mbushja e fugave Dizajni sipas organit mbikqyres	m ²	75.00	12.00 €	900.00
A.14.2	Furnizimi me material dhe mvëshja e dyshmeve (sanitaret) me pllaka të qeramikës te kualitetit te lartë, me ngjites adekuat, ne qmim te parashihen edhe mbushja e fugave Dizajni sipas organit mbikqyres	m ²	35.00	12.00 €	420.00
A.14.3	Furnizimi dhe mvëshja e dyshemesë se koridorit, hollit hyres, hapsirave per shume qellime erembrojteseve dhe hapsirave tjera me pllaka te granitit artificial 60x60 cm me ngjites adekuat, ne qmim te parashihen edhe mbushja e fugave dizajni sipas investitorit, si dhe furnizimi dhe vendosja e qeramikës ose granitit artificial rreth perimetrit te mureve ne lartesi t=10.0 cm	m ²	195.00	12.00 €	2,340.00
A.14.4	Furnizimi dhe mvëshja e shkalleve dhe platove te jashtme me pllaka teraco me trashesi t=2.0 cm. Dizajni sipas perzgjedhjes se Investitorit	m ²	145.00	12.00 €	1,740.00
A.14.5	Furnizimi dhe mvëshja e sallobankave te dritaret në anen e jashtme dhe të brendshme mermeri me trashësi 2cm dhe me gjerësi të duhur (të nevojshme). Të parashihet që nga ana e jashtme të del 5 cm nga muri. llogaria ne m' Vërejte: Të konstruktohet edhe rënia e nevojshme e pikores nga ana e jashtme.	m'	75.00	8.00 €	600.00
				GJITHSEJ:	6,000.00
A.15	PUNËT E LINOLEUMIT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.15.1	Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë se linoleumit me trashësi t=3 mm (ne rolne) lidhja behet me ngjites adekuat, ne llogari te merret shtresa vetenivilizuese, ngjites adekuat, diktuni dhe shiriti rreth perimetrit te mureve ne lartesi h=8 cm, si dhe vendosja e profileve metalike, në vendet ku bëhet kontakti në dysheme me material tjetër.	m ²	380.00	20.00 €	7,600.00
				GJITHSEJ:	7,600.00
A.16	PUNËT TJERA	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.16.1	Furnizimi, dhe vendosja ne mure, mbrojtësëve nga druri i perpunuar dhe l lyer me dimensione 150x20 mm,	m'	130.00	3.00 €	390.00
A.16.6	Furnizimi l materialit dhe punimi l gardhit te rampave dhe hyrjeve te jashtme me profile matalike duke parapa edhe ngjyrosjen	m'	14.00	40.00 €	560.00
				GJITHSEJ:	950.00
A.17	NDËRTIMI I FUSHËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.17.1	Gërmimi l humusit në thellësi prej mes. 45 cm, germimi duhet te behet ne tere siperfaqen e fushes se futbollit, si dhe transporti l dheut deri ne deponi.	m ³	320.00	0.50 €	160.00
A.17.2	Rrafshimi dhe nivelizimi l nënbazës së sipërfaqes së fushës me saktësi deri në ±2 cm,duke krijuar pjerresin e nevojshme terthore per kullimin e ujrave siperfaqesore, ngjeshja me cilindër vibruës deri ne arrijten e kompaktesis prej Ms= 30 Mpa.	m ²	650.00	1.00 €	650.00
A.17.3	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri l thyer me frakison 0-63 mm me trashesi t=20 cm ne gjendje te ngjeshur (Ms=50 Mpa) .	m ³	145.00	4.50 €	652.50
A.17.4	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri l thyer me frakison 0-31.5 mm me trashesi t=10 cm ne gjendje te ngjeshur (Ms=70 Mpa) .	m ³	66.00	5.00 €	330.00
A.17.5	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e asfaltit betonit AB 16 mm me trashesi t=7 cm ne gjendje te ngjeshur, Siperfaqes duhet ti ipet ramja per largimin e ujërave atmosferike. llogaria ne meter katrore.	m ²	660.00	15.00 €	9,900.00
A.17.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve me dimensione 8/20 cm per kufizimin e fushes , ne qmim te llogaritet betoni per shtangimin e skajoreve	m'	103.00	4.00 €	412.00
A.17.7	Trajtimi dhe rregullimi l siperfaqes per rreth fushes dhe mbjellja e barit	m ²	150.00	1.50 €	225.00
A.17.8	Te behet furnizimi dhe punimi l vijave te fushes me ngjyre te akrilike kualiteti te larte e qendrusheme ndaj ndikimeve atmosferike me nuance te bardh sipas projektit , llogaria komplet	komplet	1.00	100.00 €	100.00
A.17.9	Te behet furnizimi dhe punimi l vijave te fushave ndihmese te basketit me ngjyre te akrilike kualitetit te larte e qendrusheme ndaj ndikimeve atmosferike me nuance te verdh sipas proeiktit , llogaria komplet	komplet	1.00	100.00 €	100.00



[Handwritten signature]

A.17.10	Te behet furnizimi,transporti dhe vendosja e gollave ne fushe me dimensione 3x2 m te parashihet edhe rrjeta adekuat sipas detalit ne projekt.	copë	2.00	150.00 €	300.00
A.17.11	Te behet furnizimi,transporti dhe fiksimi i koshave per basketboll. Ne qmim te kalkulohet hapja e gropes, betonimi, konstruksionit metalik, tabela koshi dhe te gjith aksesoret tjer perxjelles	copë	2.00	400.00 €	800.00
				GJITHSEJ:	13,629.50
A.18	NDERTIMI I PLATOS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
A.18.1	Gërmimi i humusit në thellësi prej 30 cm, gërmimi duhet te behet ne tere siperfaqen e platos, si dhe transporti i dheut deri ne deponi.	m ³	270.00	0.50 €	135.00
